

REXHEP QOSJA- SHKRIMTAR POSTMODERN

Adil OLLURI

Instituti Albanologjik-Prishtinë

Abstrakt

Në veprën e autorit model të praktikës postmoderne në letërsinë shqipe, Rexhep Qosjes, kemi një sërë elementesh postmoderne, si: intertekstin, citatësinë, rivizitimin e traditës kulturore, rishikimin e së kaluarës, ironinë, parodinë, paradoksin, shfrytëzimin e lirë të dokumentit, eklektikën, lojën fikzionale, double coding-un e ligjëritimit, e çdo element tjetër që mund ta bëjë një shkrimtar të jetë postmodern.

Këto elemente gjenden në romanet e tij, të cilët do të jenë objekt i këtij punimi. Këto romane shënojnë komplekse intertekstuale, të cilat ndërtohen përmes rrjetit a kombinimit të citateve, me anë të të cilave bëhet një rivizitim kulturor i së shkuarës jo aq të largët.

E gjithë kjo bëhet me anë të një diskursi ironik, i cili edhe e parodizon kohën për të cilën rrëfen në roman, parodizohet koha me plot paradokse, ku njeriu dërgohet te varret si atdhetar, ndërsa varroset si tradhtar, si hafije, apo kur njeriu që mbante mend gjithçka, për një moment e harron edhe emrin e tij, e shumë paradokse të tjera.

Fjalët kyçe: Rexhep Qosja, shkrimtar postmodern, ligjërim, elemente postmoderne, kompleks, diskurs ironik

Hyrje

Juri Lotman, në veprën e tij *Kultura dhe bumi* thekson se ndryshimet kulturore ndodhin për dy faktorë: *së pari, si zhvillim imanent, së dyti, si rezultat i ndikimeve të jashtme lloj-llojëshe*.¹ Nga këta dy faktorë, gjithsesi, ka ndodhur edhe ndryshimi drejt një diskursi specifik të letërsisë postmoderne, e cila është *një etapë e veprimtarisë estetike-artistike, një fushë globale intelektuale e kulturore, që tërheq në vakuumin e idealit estetik nostalgjinë lodërtare (nostalgjinë e lojës) e ironike*.²

Kur flasim për letërsinë postmoderne, apo për një autor të veçantë të saj, çdo njeri që përpiket t'i njohë gjërat do të pyeste: Ç'është një shkrimtar postmodern, çka e bën atë të jetë postmodern? Çfarë estetike i përmbahet ai, nëse i përmbahet ndonjë estetike, apo edhe çfarë ideologjie shpreh vepra postmoderne? Këto janë çështje që ngrihen para çdo lexuesi, kritikë a studiuesi, që dëshiron ta hulumtojë këtë tip letërsie.

Shkrimtari postmodern është në pozitën e mbledhësit të literaturës, siç është ta zëmë prokurori në pozitën e mbledhësit të fakteve, nëse na lejohet të bëjmë një analogji të tillë. Ai jo vetëm që e mbledh, por edhe e ripërpunon dhe shfrytëzon jashtëzakonisht shumë materialin kulturor, literaturën, si në mënyrë implicite të shfrytëzimit, ashtu edhe në mënyrë eksplicite, në formë citatesh, duke krijuar kështu fenomenin e citatësisë në tekstet postmoderne. Në këtë aspekt, studiuesi Agim Vinca, thekson se *citati është element konstituiv i letërsisë postmoderne*, dhe sipas tij *citatësia paraqet një nga format më eksplicite të intertekstualitetit*.³ Përdorimi i citatit në një vepër postmoderne, duke krijuar kështu një korpus citatesh brenda saj, i japin kësaj vepre një nuancë eruditive, shkencorizuese, sepse një shkrimtar postmodern mund ta përdorë, ta zëmë, një citat nga *Lahuta...* e Fishtës, a nga romanet e Sabatos, ashtu siç mund ta përdorim ne në një punim shkencor. Kjo nuancë eruditive si duket e bën veprën postmoderne një tërësi enciklopedike.

¹ Juri LLOTMAN, *Kultura dhe bumi* përkth. Agron Tufa, Aleph, Tiranë, 2004, f. 95

² <http://www.infoarkiv.com/media/artikull/iden/171657/titulli/Postmodernizmi>

³ Agim VINCA Vep. e cit. , f. 241

Rexhep Qosja, shkrimtar postmodern

Në veprën e autorit model të praktikës dhe estetikës postmoderne në letërsinë shqipe, Rexhep Qosjes, kemi një sërë elementesh postmoderne, si: intertekstin, citatësinë, rivizitimin e traditës kulturore, rishikimin e së kaluarës, ironinë, parodinë, paradoksin, shfrytëzimin e lirë të dokumentit, eklektikën, lojën fikzionale, *double coding*-un e ligjërit, e çdo element tjetër që mund ta bëjë një shkrimtar të jetë postmodern. Këto elemente gjenden në dy romanet e tij, të cilët do të jenë objekt i këtij punimi. Këto romane shënjojnë komplekse intertekstuale, të cilat ndërtohen përmes rrjetit a kombinimit të citateve, me anë të të cilave bëhet një rivizitim kulturor i së shkuarës jo aq të largët. E gjithë kjo bëhet me anë të një diskursi ironik, i cili edhe e parodizon kohën për të cilën rrëfen në roman, parodizohet koha me plot paradokse, ku njeriu dërgohet te varret si atdhetar, ndërsa varroset si tradhtar, si hafije, apo kur njeriu që mbante mend gjithçka, për një moment e harron edhe emrin e tij, e shumë paradokse të tjera. Përveç paradoksit, romanet i karakterizon edhe eklektizmi (përzierja), ta zëmë te *Vdekja më vjen prej syve të tillë* kemi një përzierje të diskurseve, ku po të shikohen tregimet (pjesët e veçanta) *Legjenda* dhe *Trilogjia*, do të vërenim se në të parin kemi një teknikë përrallore të rrëfimit dhe një diskurs legjendarizues, ndërsa në të dytin kemi një rrëfim realist që realizohet përmes diskursit satirizues. Pra, vërehet qartë që kemi një eklektikë të diskurseve letrare. Për dallim prej tij, romani tjetër *Një dashuri dhe shtatë faje*, ka një përzierje jo vetëm të diskurseve letrare, por edhe ndërmjet diskurseve letrare e jolettrare, madje edhe përzierje ndërmjet diskurseve humane, ku në këtë roman kemi një përzierje ndërmjet diskursit dokumentar dhe atij fikcional, letrar, duke krijuar oksimoronin *dokumentar fikcional*,⁴ që është kulmi i paradoksalitetit. Kjo përzierje në fakt krijon elementet e lojës fikzionale, lojës me kohën etj.

Edhe pse këto romane kanë pothuajse të gjitha elementet e postmodernes, tema e këtij punimi do të fokusohet vetëm në dy elemente mjaft domethënëse për teorinë dhe praktikën postmoderne: *intertekstin* dhe *citatësinë postmoderne*. Edhe pse duket se këto dy nocione duken të njëjta, nocione që e nënkuptojnë njëri-tjetrin, ato kanë dallim thelbësor ndërmjet vete, sepse interteksti nënkupton relacionin e një teksti me tekstin tjetër, si në nivelin formal e stilistik, ashtu edhe në nivelin tematik. Ndërsa, me citatin a citatësinë nënkuptojmë një relacion eksplicit ndërmjet teksteve. Citatet mund të vërehen nga çdo lexues, ndërsa interteksti mund edhe të mos vërehet nga lexuesi e kritiku, sepse citati është shënim i fjalëpërfjalshëm i një teksti në tekstin tjetër, kurse interteksti nuk është i tillë. Studiuesi francez, Zherar Zhenet, thotë se, *intertekstualiteti është prania literale ose integrale e një teksti në tekstin tjetër*. Ndërsa, në anën tjetër, ai thotë se *citimi nënkupton thirrjen eksplicite të një teksti, njëkohësisht të pranishëm e të distancuar përmes thonjzave*.⁵ Zheneti flet edhe për nocionet e tjera që janë pjesë e teorisë së intertekstualitetit, si: *hipoteksti* (teksti i shfrytëzuar), *hiperteksti* (teksti i prodhuar), *arkiteksti* (teksti i vjetër) etj; të cilët këtu do të mund t'i përdorim për qëllime operationale. Studiuesi Agim Vinca, në një rast nocionin *intertekst* e shqipëron si *ndërtëkstori*⁶, por ne do ta përdorim trajtën ndërkombëtare, ashtu siç pajtohet edhe shqipëruesi i tij.

Në romanet postmoderne të Rexhep Qosjes kemi një relacion e intertekstual e citatësor me tekstet letrare, dokumentet kulturore, me të kaluarën në përmasat e një kompleksi referencial, apo, më mirë të themi, kemi një relacion enciklopedik të teksteve të Qosjes me literaturën. Ky relacion zhvillohet me *Biblën*, *letërsinë popullore*, *Kur'anin*, *Monteskjen*, *Fishtën*, *Shekspirin*, *Sabaton* etj. Pra, në këtë punim do të trajtohen nivelet dhe mënyrat e paraqitjes së intertekstit dhe citatësisë në këto romane.

Ndërlidhja e romaneve të Rexhep Qosjes me literaturën, veprat e mëhershme letrare, dokumentin kulturor dhe historik, i bën ato të kenë përmasa enciklopedike. Kjo gjë paraqitet si

⁴ Ag APOLLONI: "Dokumentar fikcional", FOKUS (gazetë e përjavshme), 9 shkurt, 2007, f. 19

⁵ Zherar ZHENET: "Figura", Rilindja, Prishtinë, përkth. Sabri Hamiti dhe Binak Kelmendi, 1985, f. 84

⁶ Agim VINCA: "Kurs i teorisë letrare (Prej antikës deri te postmodernizmi)", Libri shkollor, Prishtinë, 2002, f. 239

në nivel të mbarështrimit të elementeve citatësore, po ashtu edhe në nivel të *informacionit semiologjik*⁷ që sjellin këto romane. Ky relacion intertekstual dhe citatësor i romaneve me këtë korpus a shumësi tekstesh e bën Rexhep Qosjen shkrimtar erudit, shkrimtar që vë në plan të parë erudicionin, pastaj kreacionin. Kjo është zaten edhe premisë domethënëse e poetikës së postmodernizmit, ku erudicioni vihet gjithmonë para kreacionit. Sipas studiueses, Rusana Hristova- Bejleri, *vitet 70 shënojnë fillimin e postmodernizmit në Kosovë dhe vepra e Qosjes është shenjë e këtij fillimi*.⁸

Rexhep Qosja është edhe një intelektual shqiptar, që la gjurmë të pashlyeshme në kulturën shqiptare të Kosovës. Ai përpos romaneve ka shkruar edhe një sërë veprash të tjera, në fushë të kritikës letrare, historisë letrare, publicistikës etj. Ndër veprat kryesore të tij janë: *Episode letrare* (1967), *Dialogje me shkrimtarë* (1968), *Kritika letrare* (1969), *Antologji e lirikës shqipe* (1970), *Kontinuitete* (1972), *Asdreni- jeta dhe vepra* (1972), *Panteoni i rralluar* (1973), *Shkrimtarë dhe periudha* (1975), *Anatomia e kulturës* (1976), *Mite të zhveshura* (1978), *Prej tipologjisë deri te periodizimi* (1979), *Morfologjia e një fushate* (1980), *Nocione të reja albanologjike* (1983), *Historia e letërsisë shqipe- Romantizmi I, II, III* (1984-85), *Porosia e madhe* (1986), *Populli i ndaluar* (1990), *Fjalor demokratik* (1997), *Çështja shqiptare* (1998), *Ligjërime paravajtëse* (1998), *Paqja e përgjakshme* (1999), *Tronditja e shekullit I,II*, (2001), *I ringjalluri i penduar* (2002), *Tri mënyra të shkrimit shqip* (2005) etj.⁹ Me këtë kompleks të veprave ai ka krijuar një gamë të gjerë të veprimtarisë së tij shkencore, publicistike e letrare, duke e shndërruar veprën e tij në një urë ndërlidhëse ndërmjet gjeneratave. Lidhur me gamën e veprimtarisë shkrimore të Rexhep Qosjes, Robert Elsi thotë se *ai është kritiku më produktiv në Ballkan*.¹⁰ Kur jemi te kritika letrare, mund të themi se Qosja në shkrimet e tij kritike, ndjek një model integralist të vështrimit, i cili nënkupton studimin e një veprë në të gjitha aspektet (studimin integral të saj). Veçori e modelit të tij kritik është edhe integraliteti metodik. Kjo do të thotë se edhe në punë të metodave mbi studimin e letërsisë, ai është një tip ndryshe. Qosja nuk i përmbahet një metode studimore, si ta zëmë strukturalizmit apo formalizmit, por edhe në këtë pikë ndjek një princip integral, duke i integruar apo shfrytëzuar të gjitha metodat në studimin e tij, varësisht sa shfaqet nevoja e tekstit letrar për to. Është një studiues letrar që metodën e shfrytëzon për tekstin letrar, e jo tekstin për metodën. Pra, ai është *përtej shkollave*¹¹, siç do të thoshte Todorovi, ku shkollat nënkuptojnë metodat mbi studimin e artit letrar. Ndërsa, në shkrimet publicistike, si pikë kryesore e interesimit të tij është çështja shqiptare. Rexhep Qosja me veprimtarinë e tij diskursive, me shkrimet e tij publicistike, që mbronin denjësisht të drejtën shqiptare, *në vitet '80, në një kohë të monizmit jugosllav, ishte bërë një frymëzues për shumë intelektualë të rinj të Kosovës, të cilët donin ta ndryshonin pozitën e popullit shqiptar, që gjendej brenda territorit të ish-Jugosllavisë*.¹²

Ky dimension i gjerë i fushëveprimit letrar, intelektual e njerëzor, e bën Rexhep Qosjen, të lindur në Vuthaj të Gucisë (1936), një shkrimtar e intelektual me natyrë eruditive dhe enciklopedike. Këtë natyrë më së miri e theksojnë dy romanet e tij *Vdekja më vjen prej syve të tillë* (1974) dhe *Një dashuri dhe shtatë faje* (2003), për të cilat u fol në këtë punim. Padyshim që me këto dy romane, shkrimtari Rexhep Qosja, ka zënë vend të rëndësishëm në rrjedhat e letërsisë shqipe, duke u bërë iniciues dhe autor ilustrues i një poetike në këtë letërsi: Poetikës së postmodernizmit.

⁷ Umberto EKO: “*Struktura e papranishme*”, përkth. Rexhep Ismajli, Dukagjini, Pejë, 1996, f. 65

⁸ Rusana HRISTOVA-BEJLERI: “*Letërsia shqiptare dhe çështja e homogjenitetit në krahasim*!”, <http://www.zeriyt.com/revista-letrare-zeriyt/letersia-shqiptare-dhe-ceshtja-e-homogjenitetit-ne-krahasim-t36052.0.html>

⁹ Hasan HASANI: “*Leksikoni i shkrimtarëve shqiptarë*”, Faik Konica, Prishtinë, 2003, f. 364

¹⁰ Robert ELSIE: “*Historia e letërsisë shqiptare*”, përkth. Abdurrahim Myftiu, Dukagjini, Prishtinë, 2001

¹¹ Tzvetan TODOROV: “*Letërsia në rrezik*”, përkth. Mehdi Halimi, Buzuku, Prishtinë, 2007, f. 25

¹² Ahmet QERIKI: “*Fenomenet shqiptare*”, Radio Kosova e Lirë, Prishtinë, 2005, f. 119

Citatësia si zgjerim semantik i tekstit

Në tekstet letrare postmoderne, citatet kanë edhe funksionin e zgjerimit semantik të tekstit a veprës në të cilën bëjnë pjesë. Ato jo vetëm që e rrisin, e zgjerojnë kuptimin e tekstit, por edhe e zhvillojnë një proces të dykuptimësisë së tij. Për ta vërtetuar këtë do t'i marrim tri citate që i përdorë Qosja në romanet e tij të lartpërmendura, për t'i parë se si funksionojnë në dimensionin e tyre të ri:

*Unë nuk do ta harroja kurrë më, ama bash, siç thuhet në Korbin e Edgar Allan Po-së: KURRË MË!*¹³

*Iu gjet romani i Stendalit E Kuqja dhe e Zeza*¹⁴

*Tani thonë: duart e Danjollit të Sherkës janë më të zeza se duart e Judës*¹⁵

Në citatin e parë, i cili inkorporohet në pjesën e parë që mban titullin *Profeti më kishte thënë*, që, e shkëputur nga romani mund të funksionojë si novelë më vete, kemi një përmendje të poemthit Korbi të E. A. Po-së, veçmas të refrenit të tij: KURRË MË! Këtë sintagmë antologjike e citojnë shumë vepra letrare, por, këtu duhet të pyesim se si funksionon ky citat, çfarë funksioni ka ai në pjesën e tekstit ku paraqitet? Këtu flitet për profetin, Mihran Kumanin, dhe subjekti rrëfyes, narratori, thotë se nuk do ta harrojë atë, ndërsa ky citat nga E.A. Po vetëm sa e shton, e përplotëson, nivelin stilistik të kësaj pjese, dhe jo vetëm nivelin stilistik, por edhe nivelin ideor, sepse duke e cituar këtë varg të Po-së sugjerohet për një mbamendje të përhershme për profetin, sepse vetë ky varg e ka atë nënshtresën semantike të përhershmërisë, eternalitetit.

Citimi i dytë gjendet në pjesën që ka statusin strukturor të intermexos, *Nga fletorja e shënimeve*; kjo është intermexo e dytë narrative që fillon fill pas novelës *Ethe dje, ethe sot*. Këtu citohet titulli i romanit të Stendalit *E Kuqja dhe e Zeza*, dhe tregohet për një djalë të ri që burgoset, vetëm pse në dhomën ku lexonte ai gjendet ky roman. Pyetjes se si është e mundur të burgoset njeriu, vetëm pse lexon një libër, që thënë shkurt nuk ka përmbajtje nacionale, mund t'i përgjigjemi nëse e lexojmë pjesën (*Fletoren...*) në tërësi, ku do të vërejmë se teksti flet për një kohë në të cilën zhvillohet një fushatë e egër kundër ngjyrave *kuq e zi* (ngjyrat e flamurit kombëtar shqiptar). Dhe, titulli i romanit të shkrimtarit francez bëhet shkak për burgosjen e të riut. Kjo referencë është një zgjedhje stilistike e qëlluar e shkrimtarit, një gjetje e duhur në vendin e duhur, një shfrytëzim adekuat i literaturës, për të treguar pozicionin e intelektualit të Vajazanit, të një intelektualit potencialisht të dënuar, apo të një intelektualit, i cili në çdo moment mund ta priste arrestimin dhe dënimin.

Citati i tretë gjendet te romani *Vdekja më vjen prej syve të tillë* apo më konkretisht te tregimi *Vetëvrasja*. Në këtë citat kemi një përngjasim të karakterit të Danjollit dhe figurës biblike apo karakterit të Judës, madje këtu Danjolli përshkruhet më i zi se Juda. Kjo analogji ndërmjet këtyre dy figurave është shumë funksionale, sepse edhe figura më antagoniste e Rexhep Qosjes, Danjolli i Sherkës, ka tradhtuar në një mënyrë rrethnë e tij, njerëzit e tij, njësoj siç bën Juda, simbol i tradhtisë në planin universal. Pra, thënë metaforikisht, Danjolli i Sherkës është Juda i Vajazanit.

Nga këto tri citate, që i shënuam, njëri dialogon me veprën letrare, i dyti me titullin e një veprë letrare dhe i tretë dialogon, apo thënë më mirë, shfaq relacione citatësore, me një karakter të traditës kulturore. Këto janë pika ilustruese për ta vërtetuar faktin teorik-letrar se citatësia në diskursin postmodern nuk është vetëm zgjerim stilistikor, por edhe zgjerim semantik i tij. Në

¹³ Rexhep QOSJA *Një dashuri dhe shtatë faje*, roman, Toena, Tiranë, 2003, f.15

¹⁴ Po aty f. 128

¹⁵ Rexhep QOSJA *Vdekja më vjen prej syve të tillë*, roman, Rilindja, botim i katërt, Prishtinë, 1986, f. 223

këtë tip letërsie kemi një kompleks këso citimesh të shfrytëzuara, por këtu po i përdorim këto tri, sa për ta ilustruar këtë tezë për tri nivele të shënimit citatësor: *Veprën* (fjalën artistike), *titullin* (konotacion i titullit) dhe *karakterin* (personazhin e një vepre a kulture

Përfundim

Rexhep Qosja është autor model i poetikës së potmdernizimit në letërsinë, duke qenë njëkohësisht edhe krijues prijëtar i kësaj poetke në letrat shqipe. Ai shkroi romanet që janë lexuar dhe vlerësuar lart nga lexuesi dhe kritika jonë letrare.

Romanet e tij kanë një sërë elementesh të poetikës postmoderne, për të cilat folëm edhe pak më sipër, si kompleksin intertektual, kompleksin citatësor, dokumentaritetin, paradoksin. Po ashtu, romanet e tij i karakterizon edhe eklektizmi (përzierja), ta zëmë te *Vdekja më vjen prej syve të tillë* kemi një përzierje të diskurseve, ku po të shikohen tregimet (pjesët e veçanta) *Legjenda* dhe *Trilogjia*, do të vërenim se në të parin kemi një teknikë përrallore të rrëfimit dhe një diskurs legjendarizues, ndërsa në të dytin kemi një rrëfim realist që realizohet përmes diskursit satirizues. Pra, vërehet qartë që kemi një eklektikë të diskurseve letrare.

Referencat

- [1]. QOSJA, Rexhep, *Vdekja më vjen prej syve të tillë*, roman, Rilindja, botim i katërt, Prishtinë, 1986
- [2]. QOSJA, Rexhep, *Një dashuri dhe shtatë faje*, roman, Toena, Tiranë, 2003
- [3]. APOLLONI, Ag, *Dokumentar fiksional*, FOKUS (gazetë e përjavshme), 9 shkurt, 2007
- [4]. EKO, Umberto, *Struktura e papranishme*, përkth. Rexhep Ismajli, Dukagjini, Pejë, 1996,
- [5]. ELSIE, Robert, *Historia e letërsisë shqiptare*, përkth. Abdurrahim Myftiu, Dukagjini, Prishtinë, 2001
- [6]. HASANI, Hasan *Leksikoni i shkrimtarëve shqiptarë*, Faik Konica, Prishtinë, 2003,
- [7]. TODOROV, Tzvetan, *Letërsia në rrezik*, përkth. Mehdi Halimi, Buzuku, Prishtinë, 2007
- [8]. HRISTOVA-BEJLERI, Rusana, [Letërsia shqiptare dhe çështja e homogjenitetit në krahasim!](http://www.zeriyt.com/revista-letrare-zeri-yt/letërsia-shqiptare-dhe-çështja-e-homogjenitetit-në-krahasim-t36052.0.html), <http://www.zeriyt.com/revista-letrare-zeri-yt/letërsia-shqiptare-dhe-çështja-e-homogjenitetit-në-krahasim-t36052.0.html>
- [9]. LLOTMAN, Jurij, *Kultura dhe bumi* përkth. Agron Tufa, Aleph, Tiranë, 2004, f. 95
- [10]. QERIQI, Ahmet: *Fenomene shqiptare*, Radio Kosova e Lirë, Prishtinë, 2005
- [11]. VINCA, Agim, *Kurs i teorive letrare (Prej antikës deri te postmodernizmi)*, Libri shkollor, Prishtinë, 2002, f. 239
- [12]. ZHENET, Zherar, *Figura*, Rilindja, Prishtinë, përkth. Sabri Hamiti dhe Binak Kelmendi, 1985